



## RS35 ROOF STOP



PAKETIMI

0.75L / 3L / 9L



KOHA E THARJES

3-4 Orë



KONSUMI

5 m<sup>2</sup>/l

### Përshkrim

ROOF STOP është një bojë e bardhë e përgatitur nga një emulsion i tipit "polimer në ujë" e destinuar për lyerje terrace dhe mur. RS ROOF STOP është një izolues i shkëlqyer kundra lagështirës në tarracë dhe në mur.

### Aplikimi

Presim anët e sipërfaqes me izolues të holluar në raportin 1 : 1 me ujë. Kur prerjet të jenë tharë mirë, kalojmë dorën e dytë. Në qoftë se do të përdoret mbi tarracë, materiali duhet të jetë më i trashë, kështu që hollimi me ujë duhet të bëhet deri në atë masë që të mund të punohet me rrul ose me furçë.

Në qoftë se do të përdoret në mur, materiali duhet të jetë më i hollë, por gjithmonë duhet të kihet parasysh që të krijohet një film i trashë mbrojtës.

RS ROOF STOP është i rezistueshëm në kushte të vështira atmosferike dhe në mënyrë elastike ndjek sipërfaqen ku është aplikuar. Garanton për një kohë të gjatë mbrojtjen kundra lagështirës.

### Mbulimi

RS ROOF STOP mbulon 5 m<sup>2</sup>/L në varësi të sipërfaqes.

### Paketimi

0.75L, 3L dhe 9L.

### Kujdes

Nuk lejohet aplikimi i izoluesit në sipërfaqe të njoma dhe në kushte të larta lagështie të mjedisit. Nuk lejohet përdorimi i izoluesit në temperaturë më të vogël se 50C. Pas përfundimit të lyerjes pajisjet duhet të lahen menjëherë me ujë dhe sapun.



## SKEDA TEKNIKE (NË +23°C DHE 50% U.R.)

Aparenca	Emulsion ujqor i bardhë
Densiteti (ISO2811, DIN 53217, ASTM D 1475)	1.57-1.63 g/cm <sup>3</sup>
Vizkoziteti (RVDV -2T,R7)	1000-6000 cp
Mbetja e thatë (Termostat, 105°C/2orë)	≤ 65 %
Forca ndërmolekulare (RVDV -2T,R7)	20000-100000 newton/m <sup>2</sup>
Vizkoziteti kinematik (RVDV -2T,R7)	700-5500 mm <sup>2</sup> /s
pH	≥8
Imtësia e grimcës (Elcometer 2050, ISO 1524; ASTM D 1210)	10-30 μm